

PROÇESVERBAL MBLEDHJA 27.03.2025

I mbajtur sot me date 27.03.2025 ora 10:00 në mbledhjen e Keshillit Bashkiak me rendin e ditës:

1. “Projekt-vendim për miratimin e ndihmës ekonomike 6% muaj Shkurt 2024”.
2. “Projekt-vendim për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”.

Të ndryshme .

Pjesëmarrja :Kryetare e Keshillit Bashkiak zjEdlira LLESHI

Anetaret e Keshillit Bashkiak sipas prezences në mbledhje.

Të Ftuar:Kryetare e Bashkisë zj Majlinda Cara

Drejtori I ndihmes ekonomike z Llesh Ndoci

Drejtoresha e financave zj.Rake Kola

Mbledhja e hapur për publikun .

Zj Edlira LLESHI : Mbeshtetur në ligjin 139/2015 Për vetëqeverisjen- vendore duke vënë re edhe numrin e këshilltarëve deklaroi hapjen e kësaj mbledhje.

A kemi diçka për të shtuar rendit të ditës apo fillojmë votim rendin e ditës ?

Po kemi dy kërkesa për të shtuar rendit të ditës për diskutim.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Jeni dakord që kërkesa e këshilltarit Altin Bruka të hyjë në rendin e ditës? Të lutem, numëroi votat. Kundër? Miratohet. Atëherë, futet në rendin e ditës.

Edmond Stojani, Këshilltar (PSD):

Një kërkesë është dorëzuar në sekretari. Bëhet fjalë për një familje në nevojë. Duhet të verifikohet nëse përfiton ndihmë ekonomike apo ndonjë formë tjetër ndihmese.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit:

Atëherë e fusim në rendin e ditës, nëse janë dakord edhe këshilltarët e tjerë, dhe e diskutojmë. Kush është dakord?

Edmond Stojani, Këshilltar (PSD):

Me kusht që të jetë minimalisht një këshilltar pjesëmarrës në komisionin e verifikimit.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit:

Në rregull. E diskutojmë pa tjetër.

Pika e pare e rendit të ditës 6% per muajn Shkurt 2025.Kush e don fjalën për të diskutuar ?

Llesh Ndoci drejtori i ndihmes ekonomike :Ne këtë muaj trajtojmë 128 familje për fondin e 6% .Prej tyre 56 familje njësia Laç,Mamurrasi 34 familje,Miloti 31 dhe Fushe-Kuqe 7 familje.

z.Anton Kolziu Këshilltar;Kjo lista e përfituesve a është e mundur të ndahet në lagje?

Llesh Ndoci drejtori i ndihmes ekonomike;Nuk po e kuptoj pyetjen por secila familje kanë ca të dhëna.

Majlinda Cara, Kryetare e Bashkisë;Drejtor,Këshilltari po të thotë thjeshtë a mundet të ndahet në lagje lista e përfituesve ?Pëshembull njësia Laç ka 56 familje në cilat lagje janë këto familje?

Llesh Ndoci drejtori i ndihmes ekonomike :Ne nuk e kemi bërë ndonjëherë këtë ndarje por do shohim a mund të bëhet në bazë të ligjit.

Zj. Aida Skeja Këshilltare: Sipas të dhënave, në njësitë administrative, konkretisht në lagjet 5 dhe 6, rreth 6% e popullsisë është në kushte të vështira ekonomike.

Po diskutojmë për familjen Hasani. Nëse është e mundur, të shqyrtojmë mundësinë për ta përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike ose për t'i akorduar një ndihmë të veçantë.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit:

Po e diskutojmë tani dhe, gjithashtu, e kalojmë për votim. Të votojmë ndihmën ekonomike për këtë rast. Kush është dakord për miratimin e ndihmës ekonomike? Kundër? Miratohet.

Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës:

Vendim për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit, i cili mbështetet nga buxheti i financimit, përkatësisht transfertat e kushtëzuar e publikuar nga qeveria qendrore për menaxhimin e aktiviteteve të bashkisë.

Rake Kola, Drejtoresha e Financës: Me transfertën e vitit 2025, kemi tre kategori kryesore: Transferta për menaxhimin e shërbimeve; Transferta sektoriale për agjencitë (për vitet 2026, 2027, 2028); Të ardhurat fiskale, e cila është parashikuar në lidhje me të ardhurat fiskale të parashikuara nga bashkia, me një rritje prej 1.5%. Ky detajim është bërë për çdo drejtori dhe është pjesë e fazës përgatitore. Bashkia ka ngritur dy grupe pune: Grupi i Menaxhimit Strategjik, i përbërë nga të gjithë drejtorët dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve, të cilat drejtohen nga secili drejtor përkatës. Këto grupe do të punojnë bazuar në të dhënat që do të delegohen brenda prillit dhe majit. Secila drejtori ka përcaktuar llogaritë për të gjitha llojet e shpenzimeve, duke analizuar produktet dhe kostot përkatëse. Pas miratimit të këtij vendimi nga Bashkia, Drejtoria e Financave do ta dërgojë në Ministrinë e Financave për shqyrtim dhe miratim.

Edlira Lleshi, kryetare e Këshillit: Atëherë Shifrat i kemi të gjithë përpara. Kush ka ndonjë paqartësi ose dëshiron të diskutojë, mund të marrë fjalën. Jeni të qartë? E hedhim në votim: Kush është dakord me miratimin e tavanëve financiare? Kush është kundër? Abstenim? Nuk ka abstenim. Sekretar, të lutem numëro votat. Numërimi i votave është detyrë e sekretarit dhe nuk do të bëhet nga të gjithë këshilltarët. Për transparencë, këtë herë do ta hedhim sërish në votim, por në të ardhmen duhet të respektohet procedura standarde.

Edmond Stojani, Këshilltar PSD: Në mbledhjet e ardhshme, anëtarët e komisioneve përkatëse duhet të dalin dhe të relatojnë secilin projektvendim përpara Këshillit.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Siç e përmenda më herët, komisioni e shqyrtoi projektvendimin dhe dha informacionin e nevojshëm. Të gjithë e miratuan dhe nuk pati kundërshtime.

Edlira Lleshi, Kryetare e Këshillit: Faleminderit për kohën tuaj. Kalojmë te kërkesat. Një ndër kërkesat e dorëzuara në sekretarinë e Këshillit është për ndihmë financiare për një familje. Zonja kryetare, a mund të jepni një përgjigje tani, apo ju nevojitet më shumë kohë për të mbledhur informacionin e nevojshëm?

Majlinda Cara, Kryetare e Bashkisë: E nderuar kryetare, të nderuar këshilltarë dhe qytetarë, Patjetër që nga sekretaria e Këshillit Bashkiak kemi marrë një kërkesë, dhe sapo të miratohet, duhet shqyrtuar. Është shumë e rëndësishme që kërkesat, qoftë nga qytetarët drejtpërdrejt, qoftë përmes këshilltarëve të tyre, të adresohen si te kryetari ashtu edhe te administrata.

Për të qenë e qartë me ju dhe me qytetarët, për çdo pyetje që na drejtohet, do të japim një përgjigje të plotë. Në këtë rast, për sqarimet e kërkuara sot, do të sigurojmë informacionin e nevojshëm nga administrata. Përgjigja për këto çështje do të jepet nga kryetari i bashkisë në mbledhjen e ardhshme, ku do të trajtohen të gjitha pikat e ngritura. Faleminderit!

Edmond Stojani, Këshilltar PSD: Sikurse e përmendën edhe kolegët e tjerë, ka raste kur individë marrin deri në 2,000 € për një koncert dhe, përveç kësaj, kanë përfutur edhe ndihmë financiare prej 5,000 lekësh. Në këtë rast konkret, qytetarja ka kërkuar një ndihmë ekonomike prej 50,000 lekësh të reja, pasi familja e saj ndodhet në një situatë të vështirë. Duke marrë parasysh gjendjen e tyre, kërkoj që, nëse vendoset të bëhet një verifikim i kushteve të familjes, krahas stafit të drejtorisë përkatëse, të jetë i pranishëm edhe një këshilltar gjatë procesit të verifikimit. Kaq kisha për të shtuar.

Majlinda Cara, Kryetare e Bashkisë: E kuptoj dhe respektoj shqetësimet e çdo këshilltari për nevojat e komunitetit. Megjithatë, është e rëndësishme të kemi qartësi në lidhje me ndihmën ekonomike dhe kriteret e saj. Ndihma ekonomike funksionon përmes një sistemi të përcaktuar,

ku çdo person duhet të aplikojë individualisht. Bashkia nuk ka autoritetin për të përfshirë drejtpërdrejt familjet në skemën e ndihmës ekonomike, pasi ky proces ndjek kritere specifike të përcaktuara nga sistemi ligjor. Sigurisht, ne e kuptojmë që ka familje në nevojë dhe kërkojmë mënyra për t'i mbështetur. Por duhet të jemi të qartë që çdo vendimmarrje në këtë drejtim duhet të ndjekë procedurat ligjore dhe administrative të parashikuara. Unë, si kryetare e bashkisë, nuk mund të marr vendime jashtë këtyre rregullave, ashtu siç askush nuk mund të marrë iniciativë të pavarura jashtë sistemit të shërbimit social. Çdo kërkesë e qytetarëve për ndihmë ekonomike trajtohet në mënyrë të rregullt përmes protokollit të bashkisë dhe institucioneve përkatëse. Shërbimi Social, si pjesë e komisionit të verifikimit, shqyrton gjendjen ekonomike të aplikantëve dhe, pas një vlerësimi të detajuar nga Ministria e Shëndetësisë, sjell çështjen për diskutim në këshillin bashkiak. Ne jemi gjithmonë të hapur për bashkëpunim dhe e vlerësojmë kontributin e këshilltarëve dhe qytetarëve në adresimin e këtyre çështjeve. Sa më shumë hapësira dhe mundësi financiare të kemi, aq më shumë mund të ndihmojmë familjet në nevojë. Faleminderit!

Edmond Stojani, Këshilltar PSD: Dua të bëj një krahasim të thjeshtë: kush përfiton më shumë? Një këngëtare që për një natë merr 2,000 euro dhe gjithashtu përfiton ndihmë financiare nga bashkia, apo një familje në nevojë, e cila mezi siguron jetesën, me anëtarë të sëmurë dhe të papunë?

Majlinda Cara, Kryetare e Bashkisë: I nderuar këshilltar, për këtë çështje është e rëndësishme të kemi informacionin e plotë. Ashtu siç e njihni ju, edhe ne e njohim situatën e kësaj familjeje, pasi është trajtuar edhe më parë në këshill dhe ka marrë ndihmë financiare disa herë. Bashkia ka qenë dhe vazhdon të jetë e angazhuar për të ndihmuar këtë familje në mënyrë të vazhdueshme. Sigurisht, në bazë të kërkesës suaj dhe të familjes në fjalë, Shërbimi Social do të kryejë të gjitha verifikimet e nevojshme për të vlerësuar situatën aktuale. Për çdo detaj tjetër, mund të kthehemi te kjo çështje në mbledhjen e ardhshme të këshillit, në mënyrë që të kemi një informacion më të plotë dhe të bazuar në fakte. Dua të theksoj se si kryetare e bashkisë, unë nuk mund të veproj jashtë kuadrit ligjor apo të favorizoj dikë në mënyrë të padrejtë. Detyrimi im është të ndjek rregullat dhe të sigurohem që çdo ndihmë ekonomike të jepet sipas kritereve të përcaktuara nga ligji dhe institucionet përkatëse.

Edlira Lleshi, kryetare e Këshillit: Konfidencialitetin të lutem! Me kujdes kur përmend emrat.

z.Laurin Sana: Bojkoti i mbledhjes së kaluar erdhi si pasojë e arrogancës dhe mungesës së vazhdueshme të transparencës nga ana e kësaj Bashkie, të cilës i nënshtrohemi.

Kërkesat tona të vazhdueshme për çështje të ndryshme, për vendosjen e kamerave dhe mikrofonave – të cilat, për Atë Zot, u lodhëm duke i kërkuar po vazhdojnë të neglizhohen.

Menaxhimi i dobët i buxhetit, mungesa e seriozitetit nga secili prej jush dhe mosdhënia e rëndësisë së duhur kësaj salle dhe komunitetit që përfaqësoni tregojnë qartë se për ju çdo gjë është thjesht çështje numrash. Si rezultat, mbledhja dështoi, ndërsa nga ana jonë bojkoti ishte një shenjë proteste ndaj këtyre problematikave që përmenda më lart.

Edlira Lleshi, kryetare e Këshillit:Deklaroj mbylljen e mbledhjes Laç 27.03.2025.